# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5895
E premte, 4 tetor 2019
çmimi 0.40 €


## Rikthimi amerikan në Ballkan
FAQE 10

Prof. dr. Blerim REKA




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


ASOCIACIONI EVROPIAN PËR SIGURIMIN E CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË (ENQA) KA PËRJASHTUAR NGA RADHËT E VETA AGJENCINË E KOSOVËS PËR AKREDITIM (AKA) FAQE 3

# NDËRHYRJET POLITIKE LARGOJNË AGJENCINË E AKREDITIMIT NGA ENQA

Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) nuk i është vazhduar anëtarësia në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA). Ky përjashtim ka ardhur si pasojë e vendimit të qeverisë në shtator të vitit 2017 për ta shkarkuar bordin e AKA-s. Për këtë çështje ka reaguar Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), duke vlerësuar se vendimi i ENQA-s është shqetësues. Kurse shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Natalya Apostolova, ka thënë se ndërprerja e anëtarësimit të AKA-s është kthim prapa dhe pasojë e ndërhyrjeve politike





FLET PËR "EPOKËN E RE" KANDIDATJA PËR DEPUTETE, DR. QAMILE MORINA

# Prioriteti im, reformimi i shëndetësisë

Dr. Qamile Morina, anesteziologe, në zgjedhjet e 6 tetorit është kandidate për deputete e koalicionit AAK-PSD dhe mban numrin 78. Ajo ka qenë deputete e nënshkrimit të Deklaratës së Pavarësisë dhe ka dhënë kontribut si anesteziologe në luftën çlirimtare të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Morina ka thënë se është bërë pjesë e AAK-së dhe vizitonit të liderit Ramush Haradinaj për të dhënë kontribut në lëmin e shëndetësisë. Morina ka theksuar se prioritet i saj do të jetë reforma në shëndetësi

## Mehmet Kraja zgjedhet kryetar i Akademisë
FAQE 8

## OPINION

### REZULTATET E ZGJEDHJEVE TË 6 TETORIT: LDK-ja E PARA, LV-ja E PARA, PDK-ja E PARA... F. 12

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



### POROSIA PERSUASIVE AMERIKANE: TË VOTOHET KADRI VESELI PËR KRYEMINISTËR F. 10

Hasan MUJAJ



## AKTUALE

### NË BURGUN E SIGURISË SË LARTË FILLON PRODHIMI I LETRËS HIGJIENIKE F. 8

## EKONOMI



### BANKA BOTËRORE: KOSOVA PO INVESTON FUQISHËM NË RRJETIN ELEKTRIK F. 9

### LLUKA: SEKTORI ENERGJETIK, GJENERUES I MIJËRA VENDEVE TË PUNËS NË 10 VJETËT E ARDHSHËM F. 9

## SPORT

### DRITA DHE GJILANI DEKLASOJNË VUSHTRRINË DHE FLAMURTARIN F. 24


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051 044/367-061 028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Thaçi uron popullin gjerman për Ditën e Bashkimit të Gjermanisë



**Prishtinë, 3 tetor** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka uruar popullin gjerman me rastin e Ditës së Bashkimit të Gjermanisë. Thaçi ka thënë se rënia e Murit të Berlinit dhe bashkimi i Gjermanisë ka frymëzuar të gjitha lëvizjet demokratike në Evropë, duke përfshirë edhe Kosovën. "Urimet më të përzemërta popullit gjerman për Ditën e Unitetit Gjerman! Tre tetori i vitit 1990 është ditë historike për Gjermaninë, por edhe për tërë demokracitë e botës. Ajo ditë shënon të arritur konkrete të procesit të filluar me shembjen e Murit të Berlinit, e që më vonë do të rritej në një frymë të përgjithshme të ndryshimeve politike në tërë Evropën, duke vënë vlerat dhe parimet e lirisë e demokracisë mbi parimet e tjera. Kjo ditë ka frymëzuar të gjitha lëvizjet demokratike në Evropë e më gjerë, përfshirë edhe Kosovën, për t'u angazhuar për të drejtat dhe liritë qytetare të çdo populli. Duke kujtuar këtë ditë, shprehim mirënjohjen dhe respektin për të gjithë ato gra e ata burra që u angazhuan për ta mbajtur gjallë frymën e lirisë e barazisë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

# Drejtuesit e BE-së kërkojnë hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut

Drejtuesit në Bruksel thonë se Bashkimi Evropian ndodhet përpara një zgjedhjeje strategjike dhe vendimi për negociatat me dy shtetet ballkanike është një test për unionin për t'u qëndruar premtimeve dhe për të parë drejt së ardhmes








**Bruksel, 3 tetor** - Drejtuesit e institucioneve të Bashkimit Evropian u janë drejtuar me anë të një letre shteteve anëtare për t'i hapur negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Në letrën e firmosur nga president i Këshillit Evropian, Donald Tusk, presidenti i Parlamentit Evropian, David Sassoli, presidenti në detyrë i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker dhe presidentja në ardhje e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, theksohet se Tirana dhe Shkupi kanë bërë çfarë u është kërkuar për hapjen e negociatave.

Drejtuesit në Bruksel thonë se Bashkimi Evropian ndodhet përpara një zgjedhjeje strategjike dhe vendimi për negociatat me dy shtetet ballkanike është një test për unionin në aftësinë për t'u qëndruar premtimeve dhe për të parë drejt së ardhmes.

Në letrën e tyre thuhet se qershorin e kaluar u pajtuam të arrinin një vendim të qartë dhe thelbësor për hapjen e negociatave të pranimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë jo më vonë se tetori 2019. "Bashkimi Evropian qëndron para një zgjedhjeje strategjike. Nëse BE-ja vendos tani për t'i filluar bisedimet e pranimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë është një provë e aftësisë së Bashkimit për t'i përmbushur premtimet e saj dhe për të parë në të ardhmen. Bota jonë po pëson ndryshime të shpejta. Nëse BE-ja do ta ruajë rolin e vet ndërkombëtar dhe t'i mbrojë interesat e saj, ndërmarrja e një hapi drejt integrimit të atyre vendeve evropiane që kanë shprehur interes dhe kanë përmbushur kërkesat për fillimin e procesit të pranimit do të ndihmojë në arritjen e kësaj", thuhet në letër. "Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria bënë atë që u kërkuam të bënin. Arritja e kësaj kërkonte një përpjekje të konsiderueshme nga qytetarët e tyre, për të cilët perspektiva evropiane ka qenë një burim i shkëlqyeshëm i motivimit dhe vendosmërisë.

Nuk ka asnjë garanci për sukses. Do të ketë shumë punë të vështirë për reformat gjatë rrugës. Anëtarësimi nuk do të ndodhë brenda natës. Dhe të dy vendet janë të vetëdijshme për këtë. Paralelisht, bashkëpunimi i BE-së do të duhet të thellohet për të ecur së bashku me zgjerimin, në interesin e ndërsjellë të qytetarëve të vendeve evropiane dhe ato kandidate. Ne besojmë se tani është koha për t'i hapur bisedimet e pranimit me të dy vendet", thuhet në letrën e drejtuesve të institucioneve të BE-së.

# Merkeli: Procesi i bashkimit të gjermanëve ende nuk ka përfunduar



**Berlin, 3 tetor** - Kancelarja gjermane Angela Merkel tha se gati tri dekada pasi vendi u ribashkua, ende ka punë për të bërë, për t'i bashkuar njerëzit e ish-Lindjes dhe Perëndimit. Merkeli foli në një ceremoni që shënoi 29-vjetorin e ribashkimit në qytetin verior, Kiel. "Uniteti gjerman është një proces dhe një mision i vazhdueshëm", tha Merkeli. Ajo tha se "ribashkimi zyrtar gjerman është i plotë. Por, uniteti i gjermanëve nuk ishte i plotë më 3 tetor 1990 dhe se vazhdon të jetë edhe sot një çështje e pakryer".

Vetë Merkeli është nga ish-Gjermania Lindore, por sondazhet e fundit tregojnë se shumë banorë atje e shohin veten si të papërfaqësuar në politikën dhe bizneset gjermane, duke kontribuar në një ndjenjë të përgjithshme, që zërat e tyre shpesh nuk dëgjohen.

Muri i Berlinit, që shihet si simboli i Luftës së Ftohtë, nisi të ngrihej në vitin 1962 nga autoritetet e Gjermanisë Lindore për ta ndarë atë nga ajo Perëndimore dhe për ta ndaluar largimin drejt Perëndimit. Më 9 nëntor të vitit 1989 njerëz nga të dyja anët e Murit u ngjitën mbi të, në një frymë festive, derisa Muri u rrëzua brenda disa javësh.

Zyrtarisht bashkimi i Gjermanisë u bë më 3 tetor 1990.

## Meta: Shqipëria do të vijojë ta mbështetet fort në Gjermaninë mike

**Tiranë, 3 tetor** - Presidenti Ilir Meta ka marrë pjesë të enjten në pritjen e organizuar nga Ambasada Gjermane në Tiranë, me rastin e 3 tetorit, Ditës së Bashkimit të Gjermanisë.

Kreu i shtetit është pritur në ceremoni nga ambasadori gjerman në Tiranë, Peter Zingraf. Në një mesazh në rrjetet sociale, presidenti Meta shprehet se Shqipëria do të vijojë të mbështetet fort në Gjermaninë mike dhe partnere strategjike. "Kënaqësi të merrja pjesë sot në pritjen e organizuar nga Ambasada Gjermane në Tiranë, me rastin e 3 tetorit, Ditës së Bashkimit të Gjermanisë dhe t'i shprehja ambasadorit Peter Zingraf urimet më të ngrohta e të përzemërta për popullin mik gjerman. Shqipëria do të vijojë të mbështetet fort në Gjermaninë mike dhe partnere strategjike. Mirënjohje të thellë për kontributin e çmuar, të gjithanshëm dhe të përhershëm që Gjermania i ka dhënë Shqipërisë në procesin e integrimit evropian, konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe reformave demokratike!", shkruan presidenti Meta.



EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) ka përjashtuar nga radhët e veta Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA)

# Ndërhyrjet politike largojnë Agjencinë e Akreditimit nga ENQA

Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) nuk i është vazhduar anëtarësia në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA). Ky përjashtim ka ardhur si pasojë e vendimit të qeverisë në shtator të vitit 2017 për ta shkarkuar bordin e AKA-s. Për këtë çështje ka reaguar Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), duke vlerësuar se vendimi i ENQA-s është shqetësues. Kurse shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Natalya Apostolova, ka thënë se ndërprerja e anëtarësimit të AKA-s është kthim prapa dhe pasojë e ndërhyrjeve politike



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

**Prishtinë, 3 tetor** - Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) ka marrë vendim që ta përjashtojë Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA). Ndonëse Agjencia e Kosovës për Akreditim ishte bërë pjesë e këtij asociacioni në vitin 2014 si anëtare me të drejta të plota për një periudhë pesëvjeçare, vitin e kaluar ENQA ia ndryshoi statusin AKA-s nga anëtare me të drejta të plota, në anëtare nën shqyrtim për shkak të ndërhyrjeve politike në këtë institucion, pasi që në shtator të vitit 2017, ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MAShT), Shyqiri Bytyqi, me kërkesë të kryeministrit Ramush Haradinaj, i pati shkarkuar Bordin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe ushtruesen e detyrës së drejtorit të këtij institucioni.

Ndaj vendimit të ENQA-s ka reaguar Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), duke vlerësuar se ky vendim është shqetësues, por jo befasues. "Ky vendim është i drejtë dhe reflekton problemet strukturore të AKA-s dhe trashëgiminë e lënë pas ndërhyrjeve të vazhdueshme politike në punën e Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) vazhdimisht ka bërë publike shqetësimet rreth politizimit të procesit të akreditimit dhe cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës. KShC-ja thekson se akreditimi nuk është proces politik, por profesional dhe i bazuar në standarde evropiane të cilësisë (ESG), sipas zonës evropiane të arsimit të lartë (EHEA)", është thënë në reagimin e KShC-së. Sipas KShC-së, të gjeturat e ENQA-s janë plotësisht korrekte dhe pasqyrojnë ndikimet e jashtme dhe të brendshme me të cilat përballet AKA-ja tash e disa vjet. "Është brengosëse që AKA vazhdimisht është përballur me mungesë të mbështetjes, mungesë të burimeve njerëzore, pavarësi të cunguar, që ka pamundësuar fuqizimin dhe llogaridhënien e AKA-s. KShC-ja që në fillim të marrjes së mandatit, më saktësisht në prill të vitit 2018 deri më sot, ka vërejtur të gjitha të gjeturat e ENQA-s dhe aktualisht është duke i adresuar. Në këtë rrugëtim vendimmarrësit nuk kanë ofruar mbështetje domethënës, siç janë ndërhyrjet politike në akreditim, mungesa e drejtorit të AKA-s, ndryshime të shpeshta në Udhëzimin Administrativ për akreditim si dhe interpretime ligjore kontradiktore nga institucionet përkatëse. Theksojmë se procesi i akreditimit do të vazhdojë normalisht konform legjislacionit në fuqi", është theksuar në reagimin e KShC-së.

KShC-ja ka bërë thirrje për arritjen e një konsensusi mbarëkombëtar për përmirësimin e gjendjes dhe adresimet e të gjeturave të ENQA-s dhe vendimit të marrë. "Jemi të shqetësuar se vendimi i ENQA-s largon Kosovën nga komuniteti i zonës evropiane të arsimit të lartë dhe vështirëson barasvlerësimin e diplomave të marra nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës në Evropë dhe gjetiu. Ftojmë të gjithë hisedarët të bashkohen për arritjen e një konsensusi mbarëkombëtar për përmirësimin e gjendjes dhe adresimet e të gjitha të gjeturave të ENQA-s dhe vendimit të marrë. Kështu mbesim me shpresë se do ta realizojmë vizionin për një shoqëri me arsim cilësor sipas standardeve evropiane dhe në mbështetje të zhvillimit shoqëror dhe ekonomik në Kosovë", është thënë në reagimin e KShC-së.

### Apostolova: Ndërprerja e anëtarësimit, pasojë e ndërhyrjeve politike

Edhe shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Natalya Apostolova, nëpërmjet një deklarate për medie ka reaguar lidhur me vendimin e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) për largimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Nëpërmjet një deklarate dërguar medieve, Apostolova ka thënë se ndërprerja e anëtarësimit është një kthim prapa dhe pasojë e drejtpërdrejtë e politikave jo të shëndosha në të kaluarën, siç ishte vendimi i qeverisë në shtator të vitit 2017 për të shkarkuar të gjithë Bordin e Agjencisë pa arsyetimin e duhur. "Me keqardhje kemi kuptuar se Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ka dështuar në përpjekjet për ta ripërtërirë anëtarësimin në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA). Të qenit anëtar i kësaj organizate nuk ishte vetëm një arritje e madhe për institucionet e Kosovës, por edhe shumë e rëndësishme për ta lehtësuar mobilitetin për studentët dhe të rinjtë e kualifikuar të Kosovës. Ndërprerja e anëtarësimit është një kthim prapa dhe pasojë e drejtpërdrejtë e politikave jo të shëndosha në të kaluarën, siç ishte vendimi i qeverisë në shtator të vitit 2017 për ta shkarkuar të gjithë Bordin e Agjencisë pa arsyetimin e duhur", është thënë në reagimin e Apostolovës.

Ajo ka bërë thirrje që qeveria e ardhshme duhet t'i adresojë menjëherë të gjitha çështjet së bashku me AKA-në dhe të sigurojë që pas dy vjetësh, kur Kosova përsëri ta ketë të drejtën të aplikojë për anëtarësim, ta rifitojë me sukses vendin e vet në dy institucionet evropiane për cilësi në arsim të lartë. "ENQA ka renditur faktorët që çuan në vendimin e tyre. Është dëshpëruese të shohësh që shumica e tyre mund të adresohen me vullnet politik të qeverisë për t'i siguruar agjencisë dhe bordit të saj resurset e nevojshme. Qeveria e ardhshme duhet t'i adresojë menjëherë të gjitha çështjet së bashku me AKA-në dhe të sigurojë që pas dy vjetësh, kur Kosova përsëri të ketë të drejtën të aplikojë për anëtarësim, Kosova ta rifitojë me sukses vendin e vet në dy institucionet evropiane për cilësi në arsim të lartë. Më e rëndësishmja, qeveria e re nuk duhet t'i përsërisë gabimet e së kaluarës. Ne inkurajojmë bordin e AKA-së që t'i adresojë rekomandimet e ENQA-së dhe t'i vazhdojë përpjekjet për të siguruar cilësi në institucionet e arsimit të lartë. Bashkimi Evropian gjithmonë do të jetë i gatshëm të ndihmojë në këtë proces", është thënë në deklaratën e Apostolovës.

## MAShT-i me shqetësim pranon lajmin e largimit të Agjencisë së Akreditimit nga ENQA

Edhe Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MAShT) ka pranuar me shqetësim lajmin se Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) ka konstatuar se Agjencia Kosovare e Akreditimit nuk i përmbush rregullat evropiane për të qenë pjesë e asociacionit dhe, si e tillë, nuk mund të jetë pjesë e ENQA-s. "Megjithatë, MAShT-i për këtë lajm është njoftuar nga mediet dhe nuk ka asnjë informacion zyrtar. Prandaj, sot Ministria ka kërkuar informacion zyrtar nga Agjencia Kosovare e Akreditimit mbi raportin e ri të krijuar mes Agjencisë dhe ENQA-s e, po ashtu, edhe për të gjeturat në raportin e asociacionit, mbi bazën e të cilit është marrë ky vendim", është thënë në njoftimin e MAShT-it.



## MFK-ja dhe FKGK-ja nënshkruajnë marrëveshje për mbështetje financiare të sektorit privat

**Prishtinë, 3 tetor (ER)** - Fondacioni i Mileniumit i Kosovës (MFK), i mbështetur nga Korporata e Sfidave të Mileniumit (MCC), ka nënshkruar marrëveshjen për zbatim me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) si mekanizëm kryesor në Kosovë që mbështet qasjen në financa për sektorin privat. Kjo marrëveshje rregullon bashkëpunimin në mes të dy organizatave për ngritjen e ekspertizës dhe krijimin e dritares për kredidhënie për projekte dhe garanci për energji të ripërtërishme. Sipas kësaj marrëveshje, MFK-ja do t'i mbulojë shpenzimet e nevojshme për veprimet e FKGK-së që synojnë rritjen e kapaciteteve dhe njohurive financiare të tregut të energjisë solare.

Flet për "Epokën e re" kandidatja për deputete, dr. Qamile Morina

# Prioriteti im, reformimi i sh



Dr. Qamile Morina, anesteziologe, në zgjedhjet e 6 tetorit është kandidate për deputete e koalicionit AAK-PSD dhe mban numrin 78. Ajo ka qenë deputete e nënshkrimit të Deklaratës së Pavarësisë dhe ka dhënë kontribut si anesteziologe në luftën çlirimtare të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Morina ka thënë se është bërë pjesë e AAK-së dhe vizitonit të liderit Ramush Haradinaj për të dhënë kontribut në lëmin e shëndetësisë. Morina ka theksuar se prioritet i saj do të jetë reforma në shëndetësi. "Duhet të ndodhë një konsensus kombëtar për ta reformuar shëndetësinë. Shëndetësia nuk njeh pozitë-opozitë", ka Morina

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 3 TETOR -
**"Epoka e re":** *Znj. Morina, pse keni vendosur t'i hyni garës për deputete në zgjedhjet e 6 tetorit dhe pse e zgjodhët AAK-në?*
**Morina:** Për herë të parë që jam inkuadruar në ndonjë subjekt politik ka qenë Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD) në vitin 2006 e në vitin 2007 jam zgjedhur deputete. Kam mbetur besnike e LDD-së deri kur është vendosur që të shuhet si subjekt politik. Pas kësaj më nuk kam qenë aktive në jetën politike, por vendosa t'i përkushtohem shëndetësisë. Kësaj radhe, sidomos në muajt e fundit, duke parë se në çfarë udhëkryqi ndodhet Kosova dhe mënyra se si z. Haradinaj me vendosmëri insistoi kundër ndarjes së Kosovës, ishte arsyeja që më ka bërë të inkuadrohem në jetën politike dhe, prej të gjitha partive, zgjodha AAK-në.
Unë jam lindur dhe jam rritur në Mitrovicë dhe do të jem pjesë e atij projekti që është kundër ndarjes. Nëse ju e harroni vendlindjen, i humbisni themelet e juaja, të atij vendi që ka ndikuar në krijimin tuaj si personalitet. Prandaj Mitrovicën e konsideroj pjesë të rëndësishme të jetës sime. Z. Haradinaj është një njeri që duhet t'i besohet. Pra, kam fituar bindje se ai është një person që, nëse gjërat di t'ia prezantosh, ai të jep shtytje. Kjo më bën të shpresoj se z. Haradinaj ka mundësi që zhvillimin e shëndetësisë ta shtyjë përpara.

**"Epoka e re":** *A mund të jetë i vonshëm inkuadrimi juaj në politikë kur dihet se për t'i hyrë garës për deputete duhet pak angazhim?*
**Morina:** Ndoshta është i vonshëm për fitimin e besimit të popullatës në këto zgjedhje për arsye se nuk kam pasur mundësi të jem më herët pjesë aktive e strukturave të AAK-së. Për opinionin nuk jam person i panjohur, sepse jam anesteziologe, kam qenë deputete në periudhën kur është shpallur pavarësia e Kosovës, pra jam nënshkruese e Deklaratës së Pavarësisë, gjithashtu kam dhënë kontribut në luftën çlirimtare si anesteziologe me shumë kolegë të mi. Më herët, kur isha deputete, kam qenë shumë aktive në lëmin e shëndetësisë, duke mos përjashtuar edhe temat që kishin të bëjnë me Mitrovicën, pjesën e veriut. Si deputete e LDD-së në atë kohë angazhimi im ka qenë në të gjitha temat për vendin.

**"Epoka e re":** *Çfarë opinioni keni për shëndetësinë në vend.*
**Morina:** Shëndetësia është në nivel jo të mirë. Ka papërgjegjshmëri ndaj kërkesave të sëmurëve tanë. Shëndetësia realisht që 19 vjet nuk ka një organizim bashkëkohor, nuk kemi një menaxhment bashkëkohor. Kur

# ëndetësisë



kam qenë deputete buxheti është rritur për 80 milionë për shëndetësinë, tash buxheti është 200 milionë euro. Por, a mund të na tregojë dikush diferencën duke e pasur parasysh se tashmë dyfish është rritur buxheti?! Në ngritjen e buxhetit ka mjaft irracionalitet se si është shpenzuar buxheti. Për këtë arsye qytetari i Kosovës nuk i ndien lëvizjet që bëhen në shëndetësi. Ne duhet të kemi kohezion me sektorët qendrorë dhe primarë. Duhet ta mbrojmë pacientin prej harxhimeve për trajtimin mjekësor. Mendoj se profesionalizmi nuk është në nivelin që duhet të jetë. Kjo ka të bëjë edhe me moslidhshmërinë e Fakultetit të Mjekësisë me Qendrën Klinike Universitare. Gjithkund në botë këto dy institucione duhet të jenë kohezive. Duhet të ndodhë një konsensus kombëtar për ta reformuar shëndetësinë, përndryshe nuk ka mundësi që të reformohet ky sektor. Opozitarizmi nuk duhet të jetë në shëndetësi. Shëndetësia nuk njeh pozitë-opozitë. Të gjithë jemi pacientë dhe të gjithë herët a vonë duhet të kalojmë nëpër këtë sistem shëndetësor.

**"Epoka e re":** *Ju jeni edhe anesteziologia e parë femër shqiptare dhe përmendet edhe angazhimin tuaj edhe gjatë luftës së UÇK-së. A mjaftojnë këto veprime tuaja që qytetarët t'ju votojnë?*

**Morina:** Po, jam anesteziologia e parë shqiptare në Kirurgji. Në vitin 1998 jemi angazhuar anesteziologë dhe kirurgë me rastin e plagosjes së të ndjerit Mujë Krasniqit - "Kapuçit", ku është operuar në Likovc. Arsyeja pse unë duhet ta marr besimin e qytetarëve për deputete është se kam një përvojë jashtëzakonisht të madhe në lëmin e shëndetësisë, kam përvojë ndërkombëtare duke qenë në struktura më të rëndësishme evropiane të shëndetësisë. Besoj se kam kapacitet të mjaftueshëm për t'i lëvizur për të mirë gjërat në shëndetësi. Gjithmonë angazhimi im dhe i kolegëve ka qenë dhe është zhvillimi i anesteziologjisë. Sot anesteziologjia numëron 120 deri në 130 anesteziologë. Në kemi arritur të jemi anëtarë të Shoqatës Evropiane të Anesteziologëve. Kemi arritur të jemi anëtarë të Shoqatës Botërore të Anesteziologëve. Kemi qenë përfaqësues në trupat më të lartë të Bordit të Anesteziologëve, fillimisht isha unë dhe tash kemi përfaqësues të tjerë në këtë trup. Ne kemi bërë një punë jashtëzakonisht të madhe sepse kemi arritur ta zhvillojmë anesteziologjinë për t'i përcjellë trendët bashkëkohorë. Gjithashtu, kemi ndihmuar shumë në edukimin e stafit tonë, i cili, edhe kur po del jashtë, po respektohet. Kemi mjekimin intensiv, ndoshta më modernin në rajon! Në vitin 2007 me Bordin e Anesteziologëve të Evropës kemi filluar ta hapim qendrën për edukimin e vazhdueshëm të Evropës i cili mban kurse çdo vit, që nga viti 2008. Pra, këto janë disa prej punëve të miat që i kam bërë për shëndetësinë e vendit tim. Besoj se është një prezantim i shkurtër ky, por i mjaftueshëm që qytetarët të më votojnë.

**"Epoka e re":** *Pavarësisht zgjedheni a nuk zgjedhkeni deputete, a do ta vazhdoni aktivitetin politik në AAK pas 6 tetorit?*

Morina: Angazhimi im politik do të vazhdojë në AAK. Unë jam person i atillë që, kur diçka nuk më pëlqen, e them aty ku jam. Në dy raste, kur subjekti LDD ka kërkuar që ne si deputetë të votojmë, unë kam votuar kundër demarkacionit me Maqedoninë. Edhe në rastin e miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës kam abstenuar, sepse nuk kam dashur që një votim i tillë të bëhet me aklamacion, sepse m'i kujtonte sistemet e mëhershme. Të jemi të qartë për opinion, unë nuk kam qenë kundër miratimit të Kushtetutës, por mënyra e votimit me aklamacion ka qenë një reagim imi abstenues që nuk më ka pëlqyer. Pra, deputeti duhet ta ketë bindjen e vet, të veprojë ashtu si mendon vetë.

**"Epoka e re":** *Pritjet tuaja për koalicionin AAK-PSD më 6 tetor?*

**Morina:** Derisa nuk isha pjesë e AAK-së kam pasur një simpati për PSD-në sepse vendit i duhet një frymë e konstruktivitetit. Ne duhet të largohemi prej logjikës së kundërshtimit. Me këtë logjikë nuk fitojnë qytetarët tanë. Mënyra se si PSD-ja është munduar që t'i bëjë disa gjëra duke qenë opozitë, në shumë vendime të mëdha për vendin e ka ndihmuar qeverinë. PSD-ja ka bërë veprim konstruktiv për vendin. Po dua të them se një bashkëpunim i tillë i dy partive, njërës në pushtet e tjetrës në opozitë, ka treguar konstruktivitet. Edhe tani me qëndrimin e z. Haradinaj që ka si lider dhe me PSD-në do të jetë një kombinim jashtëzakonisht i mirë për qytetarët më 6 tetor. Mendoj se koalicioni AAK-PSD në zgjedhjet e 6 tetorit do të dalë me një rezultat të mirë. Kjo është një prej garave më të mira të pasluftës sepse të katër subjektet politike pritet të kenë një garë të afërt mes vete. Këto zgjedhje do të bëjnë një garë shumë interesante sepse askush me siguri të plotë nuk mund të thotë se janë fitues. Dallimi ndërmjet këtyre katër subjekteve do të jetë i vogël.

**"Epoka e re":** *Po pritjet tuaja si kandidate për deputete?*

**Morina:** Të jem e sinqertë, nuk kam pritje të mëdha sa i përket garës për deputete, sepse nuk kam qenë pjesë e AAK-së gjatë, pasi strukturat e saj nuk më njohin sa duhet. Por, qëllimi im ka qenë të jap kontribut në rritjen e votës së AAK-së. Megjithatë, mbes me shpresë se do të marr përkrahje nga qytetarët më 6 tetor!

# Islam Pacolli kërkon mbështetje më të madhe për gratë e AKR-së

**Prishtinë, 3 tetor (ER)** - Aleanca Kosova e Re (AKR) të enjten ka mbajtur aktivitet zgjedhorë me forumin e gruas në Prishtinë. Aty u kërkua që të mbështeten gratë dhe të votohen për deputete në Kuvendin e Kosovës. Koordinatorja e forumit të gruas, Arta Haxhaj, ka thënë se AKR-ja është mbledhur për të mbështetur gratë. Sipas saj, dëshmia e AKR-së në përkrahjen e gruas është treguar tash e disa vjet. "Punësimi i madh i grave në institucionet tona do të arrihen kur ju të jeni në Kuvend, urime dhe suksese na priftë e mbara më 6 tetor", ka theksuar Haxhaj.

Kandidatja për deputete nga AKR-ja, Mirlinda Sopi, ka kërkuar që gratë të bëhen feministe dhe të votohen gratë e AKR-së në listën zgjedhore.

Kurse, kandidati për deputet nga AKR-ja, Islam Pacolli, ka thënë se as lufta nuk mund të fitohet pa kontributin e femërie, prandaj ka kërkuar që më 6 tetor të votohen gratë e AKR-së. "Faleminderit nga ju. Sigurisht që edhe lufta nuk fitohet pa gjininë femërore, ju jeni më të përpikta se ne meshkujt. Prandaj meqenëse jeni këtu kërkoj nga ju t'i mbështesni gratë e AKR-së si dhe mua edhe për një mandat në Kuvendin e Kosovës", ka theksuar Pacolli.

Edhe kandidati për deputet nga AKR-ja, Valdrin Lluka, ka kërkuar që të votohen gratë e AKR-së, pasi sipas tij, Kuvendi ka nevojë për udhëheqjen e grave. "Mos më votoni mua, votoni gratë sepse është shumë më mirë që të kemi gra në parlament", ka theksuar Lluka.



# Veseli premton 300 çerdhe të reja dhe 1 000 euro për secilën lindje të tretë

PRISHTINË, 3 TETOR (ER) - Kandidati për kryeministër nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Kadri Veseli, në ditën e nëntë të fushatës zgjedhore ka vizituar një çerdhe në kryeqytet dhe është zotuar se gjatë qeverisjes së tij do të ndërtohen 300 çerdhe të reja në tërë vendin. Me këtë rast, Veseli ka folur edhe për rritjen e familjeve, ku ka premtuar se do ta stimulojnë lindjen e fëmijëve.

Ai ka thënë se për fëmijën e tretë familjet do të marrin një mijë euro. "Fokusi im i madh është që të bëhet futja pothuajse obliguese nga 0 deri në 6 vjeç. Kam paraparë ndërtimin e 300 çerdheve, të cilat do të jenë pikërisht në këtë qëllim. Me politikat tona ne do ta stimulojmë lindjen e fëmijës të tretë me 1 000 euro, lindjen e fëmijës së katërt me 1 500 euro. Orientimi ynë është rritja e familjes dhe përgatitja e fëmijëve tanë që të jenë të barabartë me fëmijët evropianë, për arsye se edhe konkurrenca, ambienti ku jetojmë, është evropian dhe konkurrenca duhet të jetë evropiane", ka thënë Veseli.

Kurse drejtoresha e këtij kopshti, Gëzime Rexhepi Çollaku, ka deklaruar se sfida më e madhe me të cilën përballen gjatë punës së tyre është pushimi i lehonisë. Ajo nga Veseli ka kërkuar që të gjendet një zgjidhje në mënyrë që t'u lehtësohet puna bizneseve, që edhe gratë të kenë mundësi t'i rrisin familjet e tyre.

Pretendenti për kryeministër të vendit ka premtuar se do të jetë në mbështetje të fuqizimit të çerdheve private. "Do t'u krijoj hapësirë më të madhe grave që të kenë mundësi, pastaj të kenë edhe aktivitete në punësim, në ndërmarrësi, që të mos jenë të varura vetëm prej situatës familjare", ka deklaruar Veseli.

Në ditën e nëntë të fushatës kandidati i PDK-së për kryeministër, Kadri Veseli, ka mbajtur tubim elektoral në Podujevë, Skenderaj dhe në Vushtrri.



# Konjufca: Kur do Drenica, ndryshon krejt Kosova

PRISHTINË, 3 TETOR (ER) - Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka mbajtur tubim elektoral në Skenderaj, ku ka prezantuar disa prej pikave të programit të vet qeverisës. Ndonëse në këtë tubim nuk ka marrë pjesë kandidati për kryeministër i LV-së, Albin Kurti, programin e kësaj lëvizje e kanë prezantuar kandidatët për deputetë të kësaj partie. Kandidati për deputet i LV-së, Glauk Konjufca, i ka ftuar drenicasit të votojnë për ndryshim. Ai ka thënë se kur do Drenica ndryshon krejt Kosova, duke shtuar se kjo trevë është simboli i vërtetë i ndryshimit të Kosovës. "Shumë ka vuajtur dhe shumë ka sakrifikuar populli ynë, ani pse ne kemi menduar se me lirinë do të ketë zhvillim dhe punësim por, doli e kundërta. Prej shpalljes së pavarësisë e deri sot 17 % e popullit e ka lëshuar Kosovën. Populli po thotë erdhi dita", ka thënë Konjufca.




Kurse kandidati tjetër për deputet i LV-së, Rexhep Selimi, ka thënë se ka ikur koha e atyre që mendojnë se Drenicën e kanë pronë apo çiflig. "Ka ikur koha e manipulantëve të vlerave të luftës dhe po vjen koha e veteranëve të vërtetë. Drenica është trualli i Adem Jasharit dhe dëshmorëve të tjerë, prandaj mos u ndal Drenicë, se ka ardhur koha që Drenica të bëhet bashkë me LV-në si dikur me UÇK-në ", ka thënë Selimi.

Para simpatizantëve të lëvizjes në këtë komunë ka folur edhe Nezir Bejta, kandidat i kësaj partie për deputet nga dega në Skenderaj, i cili ka thënë se qeveritë e kaluara asfaltimin e bënë për t'i larguar të rinjtë nga vendi. "Në fshatra më s'ka bujq, ky pushtet i dëboi. Këta pushtetarë na zhveshën nga gjithçka. Prandaj ky është fundi i tyre dhe turpi i tyre, se s'ka si të përfundojë, pos një ndryshimi nga Albin Kurti", ka thënë Bejta.

Lëvizja Vetëvendosje tubim elektoral ka mbajtur të enjten edhe në Klinë dhe Vushtrri.

# Limaj: Ata që po rrahin gjoks, kinse pa ta nuk bëhet shteti, e kanë gabim

PRISHTINË, 3 TETOR (ER) - Kandidati për kryeministër nga radhët e koalicionit Nisma-AKR-PD, Fatmir Limaj, ka thënë se gjatë këtyre ditëve të fushatës është takuar me qytetarë të të gjitha moshave dhe të të gjitha shtresave të shoqërisë para të cilëve ka prezantuar projektin "Bashkë për shtetin". Limaj ka thënë se qytetarë të shumtë anekënd vendit i kanë dhënë mbështetje projektit "Bashkë për shtetin" pasi, sipas tij, ky projekt afron dhe bashkon njerëz me energji pozitive e në shërbim të vendit. "Sot projekti ynë 'Bashkë për shtetin' ka ngritur në këmbë qytetarët e të gjitha moshave të cilët nuk e duan gjuhën helmuese dhe gjuhën e mashtrimeve dhe po i bashkohen projektit që i ofron e bashkon të gjithë qytetarët për të forcuar dhe ndërtuar shtetin", ka deklaruar Limaj për "Ekonomia Online".

Sipas Limajt, e kanë gabim ata që po rrahin gjoks se pa ta nuk bëhet shteti. "Po rrahin gjoks që pa mua nuk bëhet shteti, pa mua nuk çlirohet, pa mua nuk zhvillohet Kosova, pa mua nuk mbrohet Kosova. Nuk është ashtu, Kosova ka ardhur këtu bashkë, duke iu falënderuar atyre baballarëve dhe intelektualëve, punëtorëve, studentëve, vajzave dhe djemve të rinj dhe gjithë Kosovës", ka thënë Limaj.



# Haradinaj: Do të vazhdoj t'i shërbej vendit me faqe të bardhë




Prishtinë, 3 tetor (ER)- Në ditën e nëntë të fushatës zgjedhore, koalicioni AAK-PSD ka mbajtur tubim zgjedhor në Prishtinë, ku para simpatizantëve të shumtë me plisa në kokë kanë prezantuar programin e tyre.

Kandidati për kryeministër i këtij koalicioni, Ramush Haradinaj, është zotuar se sikur bardhësia e plisave që ka mbajtur në kohë, ashtu do të vazhdoj t'i shërbejë vendit me faqe të bardhë. Duke i treguar arsyet se pse ky koalicion është më i miri, ai i ka ftuar qytetarët e Kosovës që më 6 tetor të votojnë numrin 119. "Nëse duam një Kosovë që është shpija jonë të jetë një vend i sigurt, atëherë votoni për koalicionin AAK-PSD. Ky koalicion qysh ka ditur ta bëjë ushtrinë, di të ecën përpara për ta fuqizuar Kosovën", ka thënë Haradinaj.

Ai ka thënë se gjatë qeverisjes se tij e ka fuqizuar Kosovën në aspektin e sigurisë, duke ia kthyer dinjitetin policisë, gjyqësorit dhe AKI-së. "Gjyqësori më i përkrahur në rajonin tonë është gjyqësori i Kosovës, ku pagat për prokurorë dhe gjyqtarë janë dyfishuar. AKI-ja është inteligjenca e jonë dhe merr vesh para të tjerëve kur niset e keqja për Kosovën. Janë më të zotit në rajon", ka thënë Haradinaj.

Me tej, Haradinaj është zotuar se me zgjedhjen e tij kryeministër do ta fuqizojë Kosovën edhe në aspektin ekonomik. "Trepça ka për t'u kthyer në burim zhvillimi, sipërmarrësit tanë tash e tutje kanë për të na shikuar i partnerë", është shprehur Haradinaj.

Kurse, kryetari i PSD-së, Shpend Ahmeti, ka shpalosur pesë zotimet e tyre. "Nën një koalicioni AAK-PSD garanton 100 për qind territorin e Republikës së Kosovës. Kosova nuk jep territor e as pushtet me nivele të treta apo krijesa të tjera", është shprehur Ahmeti, duke shtuar se zotimi i dytë është 100 për qind zhvillim ekonomik. "Zotimi i tretë është për 100 për qind siguri sociale, vitin e parë paga minimale do të jetë 250 euro. S'do të ketë paga si mëshirë dhe punëtorët do të punojnë me kontrata të rregullta", ka thënë ai.

Sipas tij, zotimi i katërt është 100 për qind shëndetësi, kurse, zotimi i pestë është taksë 100 për qind ndaj produkteve serbe.

# Osmani zotohet për rritje të pensioneve dhe për krijimin e Fondit Pensional



Prishtinë, 3 tetor - Kandidatja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryeministre, Vjosa Osmani, është zotuar se me qeverisjen e saj barnat për pensionistë do të jenë falas, ndërsa do të ketë reformë në sistemin pensional të Kosovës. Në një bashkëbisedim me pensionistët në Prishtinë, Osmani ka deklaruar se reforma do të mundësojë rritje të pensioneve, ulje të pragut prej 15 vjetësh dhe krijim të fondit pensional.

Osmani ka vlerësuar se në qeverinë e saj investimet buxhetore do të kthehen në një investim për njerëzit e Kosovës, ku përfshihen edhe pensionistët. "Nga 6 tetori e tutje qeveria jonë do të ketë një qasje ndryshe të asaj se si udhëhiqet ky shtet. Do ta shndërrojmë ose do ta kthejmë investimin buxhetor, nga një investim që deri sot ka qenë vetëm në asfalt, në një investim në njerëzit tanë dhe kjo rrjedhimisht kërkon që buxheti kryesisht të shkojë në shëndetësi, në arsim dhe te kategoritë siç janë pensionistët", ka thënë Osmani.

Ajo ka treguar se në programin e saj është paraparë jo vetëm rritje e pensioneve, por edhe ulje e pragut prej 15 vjetësh që kërkohet për pensionistët kontributdhënës.

Ndërsa planin e LDK-së për kategoritë sociale e ka prezantuar sekretari organizativ i LDK-së, Arban Abrashi, i cili ka thënë se LDK-ja synon t`i vazhdojë punët e mira që i ka bërë për pensionistët gjatë kohës sa ishte duke qeverisur vendin. "Tek mbrojtja sociale ne synojmë të bëjmë një numër të veprimeve që mbrojnë më mirë secilin pensionist, duke përfshirë pensionet kontributdhënëse dhe pensionet e pleqërisë. Ne synojmë që këtë pragun prej 15 vjetësh ta largojmë dhe varësisht prej kontributit sa ka pasur një pensionist, ta marrë pagesën në formë të përshkallëzuar. Varësisht nga vitet e kontributit do të jetë edhe lartësia e pensionit", ka thënë Abrashi, i cili ka folur edhe për ndryshimet që LDK-ja planifikon t'i bëjë te fondi për pensionet. LDK-ja të enjten ka mbajtur tubim zgjedhor në Viti, Kamenicë dhe Prishtinë.

## Në Burgun e Sigurisë së Lartë fillon prodhimi i letrës higjienike

PRISHTINË, 3 TETOR (ER) - Shërbimi Korrektues i Kosovës ka pranuar donacion nga UNOPS-i makinë për prodhimin e letrës higjienike dhe letrës së kuzhinës. Ky donacion u dedikohet aktiviteteve të punës së organizuar nëpër burgje. Përmes këtij donacioni në Burgun e Sigurisë së Lartë do të angazhohen në punë rreth dhjetë të burgosur, e që gradualisht synohet edhe rritja e kapaciteteve prodhuese, me çka do të rritet edhe numri i të punësuarve. "Shërbimi Korrektues i Kosovës përmes këtij projekti, përveçse synon rehabilitimin dhe risocializimin e personave të burgosur, synon uljen e shpenzimeve ekonomike në letër higjienike për 50 për qind, si dhe rritjen e nivelit të higjienës dhe pastërtisë nëpër të gjitha institucionet korrektuese. Përveç kësaj, me angazhimin e të burgosurve në pune të tilla normalizohet edhe jeta e përditshme në burgje", është thënë në njoftimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Produktet e prodhuara nga të burgosurit e BSL-së do të përdoren për nevojat e të gjitha institucioneve korrektuese, e në të ardhmen të plasohen edhe në tregun vendor. "Shërbimi Korrektues i Kosovës çdoherë mbetet i përkushtuar ta vazhdojë bashkëpunimin me donatorët për projekte të tilla edhe në të ardhmen", është theksuar në njoftimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës.



# MSh, ASK e ARC nënshkruajnë marrëveshje për raportimin e indikatorëve shëndetësorë




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 TETOR - Ministria e Shëndetësisë (MSh), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) nënshkruan sot marrëveshje mirëkuptimi për raportimin e indikatorëve shëndetësorë. Marrëveshja është nënshkruar nga dr. Naim Bardiqi, sekretar i përgjithshëm i MSh-së, Isa Krasniqi, kryeshef ekzekutiv i ASK-së dhe Bekim Hoxha, drejtor i përgjithshëm i ARC-së.

Qëllimi i kësaj marrëveshje është harmonizimi i aktiviteteve dhe nënaktiviteteve për gjenerimin e raporteve për sektorin e shëndetësisë konform rregullave dhe procedurave sipas indikatorëve shëndetësorë për nevojat e institucioneve të Republikës së Kosovës, për Eurostat, UNECE, OECD dhe institucione të tjera respektive për nxjerrjen e indikatorëve për Objektivat e Zhvillimit te Qëndrueshëm 2030 (SDG) dhe institucionet e tjera.

Marrëveshja parasheh obligimet e secilës palë nënshkruese, ndërsa të dhënat e ofruara nga Ministria e Shëndetësisë/Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe Agjencia e Regjistrimit Civil, Agjencia e Statistikave të Kosovës do t'i shfrytëzojë ekskluzivisht për qëllime statistikore, respektivisht për përpilimin e raporteve dhe dërgimin e të dhënave tek institucionet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sekretari i përgjithshëm i MSh-së, Naim Bardiqi, duke falënderuar dy institucionet e tjera për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, tha se ajo do t'u ndihmojë institucioneve që të sigurojnë të dhëna të dëshmuara për indikatorët shëndetësorë dhe kjo do të ndikojë që politikat e reja në fushën e shëndetësisë të hartohen duke u bazuar në evidenca të sakta dhe në dëshmi.

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit të fillojë të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

## Mehmet Kraja zgjedhet kryetar i Akademisë së Shkencave

PRISHTINË, 3 TETOR - Akademiku Mehmet Kraja është zgjedhur kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Zgjedhja e tij në krye të AShAK-ut është bërë në mbledhjen e së enjtes të këtij institucioni.

Kjo e fundit deri në qershor ishte drejtuar nga akademiku Nexhat Daci, i cili ishte zgjedhur kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës më 21 dhjetor të vitit 2017 në zgjedhjet e rregullta.

Vendimi që Daci të mos e ushtronte më funksionin e kryetarit ishte marrë nga organet ligjore dhe statutare, legale dhe legjitime të AShAK-ut më 11 qershor të këtij viti, pasi ai i kishte mbushur 75 vjet.

Deri më sot këtë funksion e kishte ushtruar akademik Jusuf Bajraktari.



## Banka Botërore: Kosova po investon fuqishëm në rrjetin elektrik

PRISHTINË, 3 TETOR (ER) - Kosova vazhdon të renditet lart sa i përket matjes së biznesbërjes (Doing Business) nga Banka Botërore edhe për vitin 2019. Para Kosovës në rajon vazhdon të jetë vetëm Maqedonia Veriore. Banka Botërore thekson se në mbajtjen e kësaj pozite ndikim më të madh për këtë vit ka pasur, pos lehtësimit të marrjes së lejeve ndërtimore, edhe përmirësimi i energjisë elektrike. "Kosova ka rritur sigurinë e furnizimit me energji elektrike duke investuar fuqishëm në rrjetin elektrik, sikurse duke implementuar sistemin automatik të menaxhimit të energjisë për monitorimin e ndërprerjeve dhe rikthimin e furnizimit me energji elektrike", thuhet në raportin Doing Business për vitin 2019.
KEDS-i po investon vazhdimisht për ta përmirësuar rrjetin e trashëguar mjaft të vjetër. Qindra lokalitete kanë rrjet krejtësisht të rinovuar, ndërsa investimet vazhdojnë anekënd vendit, të fokusuara në zonat ku gjendja ishte më e rënduar.
Paralelisht, kompania ka punuar edhe për digjitalizimin e rrjetit.
Në avancimin e sistemeve më të fundit teknologjike, KEDS ka lansuar dy programe inovative të monitorimit të rrjetit, evidentimit të problemeve dhe raportimit në kohë reale, të apostrofuara nga Banka Botërore. Këto janë programi KOSOVANET për evidentimin e prishjeve dhe Sistemi SCADA për kontrollin mbikëqyrës të nënstacioneve elektrike dhe marrjen e të dhënave të detajuara nga këto nënstacione.




# OAK-u kërkon masa të rrepta reciprociteti me Maqedoninë

Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK) ka reaguar lidhur me pengimin e eksportit të rasadit të peshkut me origjinë nga Kosova në Maqedoninë e Veriut dhe ka kërkuar nga ministri i Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës, Endrit Shala, që urgjentisht ta zgjidhë këtë problem



PRISHTINË, 3 TETOR (ER) - Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK), është shumë e shqetësuar që prapë po pengohet eksporti i rasadit të peshkut me origjinë nga Kosova në Maqedoninë e Veriut dhe kërkon nga ministri i Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës, Endrit Shala, që urgjentisht ta zgjidhë këtë problem. "Edhe pse vendimi i datës 01. 06. 2019, me të cilin ndalohet importi i peshkut të gjallë që dedikohet për rritje ose mbushjen e hurdhave me peshq të vegjël me prejardhje nga Kosova, është shfuqizuar gjatë muajit që lamë pas, eksporti përsëri po pengohet. Ndryshimi i ligjit dhe procedurave nga ana e Maqedonisë së Veriut po bëhet një pengesë shumë e madhe jo vetëm për bizneset tona, por edhe për bizneset e Maqedonisë të cilat furnizohen nga Kosova", është thënë në reagimin e OAK-ut.
Në lidhje me këtë, OAK-u ka kontaktuar me biznesin 'Trofta' dhe me biznesin 'Fresh Fish' nga Gostivari, i cili ka theksuar se me ndryshimet e fundit që janë bërë, bizneset nuk kanë qenë të informuara paraprakisht, duke u krijuar kështu një barrierë shumë e madhe për bashkëpunim. "OAK-u kërkon nga ministri Shala që të ndërmarrë masa urgjente për reciprocitet deri në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje. Kujtojmë që bilanci tregtar Kosovë - Maqedoni edhe ashtu është në disbalancë të madhe në dëm të Kosovës", është theksuar në reagimin e OAK-ut.

## Lluka: Sektori energjetik, gjenerues i mijëra vendeve të punës në 10 vjetët e ardhshëm

GJAKOVË, 3 TETOR (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka marrë pjesë në forumin ndërkombëtar rinor për punësim të gjelbër 2019 i cili është mbajtur në Gjakovë, temat e të cilit ishin mbrojtja e ambientit, energjia e ripërtëritshme, punësimi i të rinjve dhe edukimi.
Të pranishëm në këtë ngjarje ishin ambasadorë të vendeve të huaja.
Ministri Lluka në fjalën e rastit tha se gjatë dhjetë vjetëve të ardhshëm parashihen të investohen miliarda euro të cilat do të gjenerojnë mijëra vende pune. "Kosova është në fazën finale të futjes në obligime të reja karshi direktivave të Bashkimit Evropian përmes strategjisë së përbashkët rajonale për klimë dhe energji për 10 vjetët e ardhshëm. Kjo strategji parasheh investime miliardëshe gjatë 10 vjetëve, të cilat do të gjenerojnë mijëra vende pune në Kosovë", u shpreh Luka.
Ai, po ashtu, ka thanë se nëse kujdesemi që t'i arsimojmë të rinjtë, punësimi i gjelbër do të jetë gjeneruesi më i madh i vendeve të punës. "Kosova është vendi më i ri në Evropë. Rinia, nëse angazhohet si duhet, është aseti më i madh i saj dhe kjo është grupmosha më e rëndësishme e popullsisë. Punësimi i gjelbër do të jetë punëgjeneruesi kryesor në 20 vjetët e ardhshëm, por ne duhet të kujdesemi që nuk dështojmë në edukimin e të rinjve në këto fusha", ka thënë Lluka.



GJEOPOLITIKË

# Rikthimi amerikan në Ballkan

## - Amerikanët po rikthehen në Ballkan pas mbetjes së rajonit jashtë BE-së dhe zbarkimit rus e kinez brenda tij. Cilët janë skenarët e ardhshëm?



Prof. dr. Blerim REKA

Pas 20 vjetësh mungesë, ShBA-ja e kuptoi se BE-ja e vetme nuk mund ta ndërmjetësojë paqen në Ballkanin Perëndimor dhe se ky vakum i sigurisë mund t'ua hapë derën lojtarëve jashtë BE-së. Uashingtoni aktualisht ndërmori disa masa për të siguruar që marrëveshjet kryesore në rajon të arrihen para zgjedhjeve të ardhshme presidenciale në ShBA edhe nëse kjo do të shkaktojë përplasje me Brukselin.

Pa fuqinë e Shteteve të Bashkuara, vetëm qasja e butë e Bashkimit Evropian nuk ka rezultuar të jetë e efektshme në Ballkanin Perëndimor. Pasi ShBA-ja u tërhoq nga rajoni në fillim të shekullit, tranzicioni post-konflikt, i drejtuar nga BE-ja, nuk arriti ta sjellë stabilitetin rajonal. Ky boshllëk u mundësoi hyrjen në rajon, aktorëve të tjerë që alarmoi Uashingtonin, sa e shtyri të rikthehej pas dy dekadash mungesë.

Më 1 shtator 2019 sekretari i Shtetit, Mike Pompeo, emëroi Matthew Palmer të dërguar special për Ballkanin, duke dërguar një mesazh të qartë ndaj qasjes së gjertanishme të BE-së për stabilizimin e rajonit. Disa ditë më vonë, presidenti i ShBA-së, Donald Trump, shkarkoi këshilltarin e Sigurisë Kombëtare, John Bolton, i cili mbronte një marrëveshje për ndryshimin e kufijve midis Kosovës dhe Serbisë. Ai ishte i preferuari i ministrit të Jashtëm serb Ivica Daçiq, por po aq kishte mosmarrëveshje me Pompeon. Ky i fundit, si sekretar shteti, këtë javë viziton Ballkanin, që dëshmon për rëndësinë që ShBA-ja po i jep rishtas Ballkanit. Sipas Daniel Serwerit, emërimi i ri mund të interpretohet si shenjë që ShBA-ja po synon ta mbyllë problemin e Ballkanit para zgjedhjeve presidenciale në nëntor 2020.

Për t'i shmangur tensionet e përtërira, si dhe pë ta evituar dështimin e shteteve në Ballkanin Perëndimor, ShBA po aplikon sërish modelin "Holbrooke", i cili u dha fund luftërave në ish-Jugosllavi në fund të nëntëdhjetave të shekullit të kaluar. Tërheqja e ShBA-së pas këtyre luftërave dhe lënia e Ballkanit vetëm nën kujdesin e BE-së ishte një gabim strategjik që ua hapi derën lojtarëve përtej zonës Euro-Atlantike.

### Mungesa e Amerikës

Uashingtoni e kuptoi seriozitetin e pasojave të një loje të tillë dhe vendosi të rikthehet në rajon për ta korrigjuar situatën. Fundja, të gjitha marrëveshjet e pas luftës në Ballkan nuk do të arriheshin pa përfshirjen aktive të ShBA-së.

Pa amerikanët nuk qe e mundur as Marrëveshja e Dejtonit (1995), Marrëveshja e Rambujesë (1999) dhe Marrëveshja kornizë e Ohrit (2001), të cilat sollën paqe në: Bosnjë e Hercegovinë, në Kosovë dhe në Maqedoni. Pas arritjes së paqes, nga fillimi i këtij shekulli, menaxhimi i rajonit iu transferua BE-së.

Pas luftërave në ish-Jugosllavi, BE-ja lansoi Procesin e Stabilizim Asociimit (SAP), i krijuar për t'i afruar vendet e Ballkanit Perëndimor drejt bllokut. Mirëpo, njëzet vjet më vonë vetëm Kroacia iu bashkua BE-së. Dy dekada më parë mbi 90 për qind e qytetarëve të Ballkanit ishin në favor të integrimit në BE; këtë verë numri ra në 56 për qind.

BE-ja përsërit se nuk dëshiron t'i integrojë vendet në konflikt, por as rajoni nuk është i gatshëm të presë pafundësisht para dyerve të Brukselit. BE-ja gati ngriu zgjerimin, duke ruajtur status-quon për një kohë të gjatë. Edhe pse presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se dëshiron që Ballkani Perëndimor "të ishte sa më afër BE-së", së voni, na shtetet anëtare dolën dy alternativa ndaj anëtarësimit. Disa po bëjnë thirrje për "partneritet të ngushtë" në vend të zgjerimit, duke argumentuar se Ballkani Perëndimor nuk është i përgatitur për BE. Të tjerat flasin që rajonit t'i jepet një "status special", të ngjashëm me atë për Turqinë.

Kjo politikë restriktive e zgjerimit të BE-së "shtyu" Turqinë dhe një pjesë të Ballkanit drejt Rusisë, për çka ShBA do t'i duhet t'i kthejë ato në sferën euroatlantike. Po ashtu, edhe qasja mediatore asimetrike e Brukselit, gjatë "dialogut të Brukselit" Kosovë - Serbi, nuk dha rezultat dhe nga vera filloi të korrigjohet. Kështu, më 13 gusht vendet e Quintit (ShBA-ja, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Italia) kërkuan negociata të mëtejshme, me heqjen e taksave tregtare dhe heqjen e bllokadës diplomatike të Serbisë kundër anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

Më parë, BE-ja kërkonte që vetëm Kosova t'i hiqte sanksionet e saj ekonomike kundër Serbisë, por toleroi bllokadën diplomatike kundër Kosovës, sikur edhe refuzimin e Beogradit për të vendosur sanksione kundër Rusisë. Si një shtet kandidat i BE-së, Serbia duhej ta zbatonte Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së (CFSP). Në vend që nga viti 2014 të ishte në një vijë me politikën e jashtme të BE-së, Serbia madje njoftoi se do të anëtarësohet në Unionin Euro-Azi, një alternativë strategjike për BE-në, e lansuar nga Rusia. Brukseli reagoi vetëm në gusht të këtij viti, duke paralajmëruar Beogradin që nuk mund t'iu përkiste të dy unioneve njëkohësisht.

Këto zhvillime ngritën dyshime nëse dialogu Prishtinë - Beograd do të vazhdojë? Një vit pas ndërprerjes së negociatave Prishtinë - Beograd (2018-2019), kancelarja gjermane Angela Merkel dhe presidenti francez Emmanuel Macron rinisën procesin këtë pranverë, si një iniciativë "Berlin - Paris". Paralelisht, vendet e Quintit shprehën pakënaqësinë ndaj modelit të gjertanishëm të ndërmjetësimit nga ana e BE-së. Sekretari amerikan i Shtetit, Pompeo, (në takimin me presidentin serb Aleksandar Vuçiq në gusht të këtij viti), mbështeti një "marrëveshje përfundimtare, me njohje reciproke midis dy shteteve". Madje, mediet serbe spekuluan se Serbisë iu paskan premtuar 10 miliardë dollarë dhe avionë ushtarakë - nëse e njeh Kosovën. Po sipas këtyre mediave, NATO do ta trajnojë Ushtrinë e Kosovës për rimarrjen e Kosovës së Veriut gjatë stërvitjes ushtarake "Reagimi i Përbashkët 2019", që do të mbahet në Shqipëri nga 21-24 tetor. NATO-ja dhe ShBA-ja nuk kanë komentuar spekulimet e tilla. Ndërkohë që Serbia nga Kina, bleu 9 dronë të armatosur pa pilot dhe porositi 15 të tjerë.

Është e qartë se ShBA-ja do të jetë përsëri në rajon jo vetëm në Kosovë dhe Serbi, por edhe në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, ku priten sfida shtesë të sigurisë. Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, ka deklaruar se pret "40 deri 50 ditë të trazuara" para fundit të këtij viti. Ndërkaq, me një krizë politike të vazhdueshme midis qeverisë dhe opozitës, Shqipëria fqinje gjithashtu ka frikë nga një "vjeshtë e nxehtë".

### Gara: ShBA - BE

Rikthimi i ShBA-së do ta stabilizojë rajonin, por kjo mund të çojë në një luftë të heshtur diplomatike midis Uashingtonit dhe Brukselit. Për ta shpejtuar procesin, i dërguari special i ShBA-së do të kërkojë një qasje më proaktive në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Palmer deklaroi se qëllimi i tij kryesor do të jetë që të dyja palët të kthehen në tryezë për të gjetur një marrëveshje por ai, gjithashtu, do të dëshironte që Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut të anëtarësohen në BE dhe Bosnjë dhe Hercegovina të bëhet shtet funksional.

Ky ndryshim i fundit amerikan shkaktoi tundje në Bruksel. Një zëdhënës i Komisionit Evropian menjëherë deklaroi se "dialogu do të ndërmjetësohet nga BE-ja". Deputeti gjerman Peter Beyer kërkoi që BE-ja ta caktojë gjithashtu një të dërguar special, mbase gjerman, meqë Berlini do ta marrë Presidencën e Këshillit të BE-së gjatë gjysmës së dytë të vitit 2020 dhe po atë vit edhe ulësen në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Beogradi, nga ana tjetër, u ngut që të sugjerojë që edhe Rusia duhet ta emërojë një të dërguar të vetin.

Përfshirja më e madhe e ShBA-së në Ballkan duket se do të bie ndesh me doktrinën e presidentit francez Emmanuel Macron për "sovranitetin evropian", i cili synon ta pozicionojë BE-në si një aktor me të njëjtën rëndësi gjeopolitike si: ShBA, Rusia, Kina dhe Turqia.

Kjo ripërfshirje e Amerikës mund të jetë nxitur pjesërisht edhe nga ndërmjetësi i ardhshëm i BE-së për dialogun Prishtinë - Beograd. Që nga 1 nëntori bisedimet do të drejtohen nga Përfaqësuesi i ri i Lartë për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë, Josep Borell, ministri aktual i Punëve të Jashtme të Spanjës, një nga pesë vendet e BE-së që nuk e njohin Republikën e Kosovës. I dërguari i ri amerikan për Ballkanin Perëndimor, Palmer, ishte shumë i qartë: "ShBA-ja do të dëshironte ta shihte njohjen e ndërsjellë si një pikë qendrore e marrëveshjes".

Procesi i negociatave pra po hyn në fazën e tij përfundimtare por më të vështirë, për ta përgatitur rezultatin përfundimtar: anëtarësimi në OKB për Kosovën dhe anëtarësimi në BE për Serbinë. ShBA-ja shprehu gatishmërinë e saj për t'u përfshirë në dialog kur të dyja shtetet të kthehen në tryezë. Pasi presidenti Trump vjet ua dërgoi një letër presidentëve të Kosovës dhe Serbisë, mediat serbe spekulojnë se Trump "do ta vizitojë Serbinë më 25 gusht të vitit 2020" dhe më vonë dy udhëheqësit "do të vendosin për një marrëveshje përfundimtare midis Kosovës dhe Serbisë".

### Skenarët

1. Ky kthim amerikan në rajon do të ketë një ndikim të madh në marrëdhëniet ShBA - BE, duke krijuar një betejë të re diplomatike për epërsi në Ballkanin Perëndimor. Pas mospajtimeve për Brexit-in, gazin rus, Iranin dhe mosmarrëveshjeve tregtare, BE-ja dhe ShBA-ja duket se do të përplasen edhe për Ballkanin. Për ta shmangur depërtimin rus dhe kinez në rajon, ShBA-ja do të përpiqet t'i zgjidhë urgjentisht disa çështje: marrëveshjen e Kosovës me Serbinë, anëtarësimin në NATO të Maqedonisë së Veriut, krizën e tejzgjatur politike në Shqipëri dhe krijimin e një shteti funksional në Bosnjë e Hercegovinës. Qasja amerikane pa dyshim se do të jetë më e fortë sesa trajtimi i gjertanishëm i BE-së për rajonin.

2. Nga perspektiva lokale, Maqedonia e Veriut mbase do të bëhet anëtari i 30 i NATO-s në muajt në vazhdim. Një marrëveshje midis Serbisë dhe Kosovës, gjithashtu ka të ngjarë të arrihet në vitin 2020. Më 6 tetor Kosova do të votojë për Parlamentin e ri, ndërsa në Serbi zgjedhjet parlamentare do të mbahen në pranverë. Uashingtoni u dërgoi një mesazh të qartë: "Mos votoni për politikanë të korruptuar" dhe "sillni ide të reja në dialogun Kosovë - Serbi". Deri më tani asnjë kandidat i Kosovës për postin e kryeministrit nuk është i gatshëm të pranojë ndryshimin e kufijve. Pas rikthimit të ShBA-së në Ballkanin Perëndimor, një marrëveshje përfundimtare mund të nënshkruhet në Shtëpinë e Bardhë para nëntorit 2020 - shumë ngjashëm si marrëveshja Camp David e vitit 1978, kur presidenti Jimmy Carter i dha fund luftës Egjipt - Izrael.

**(Botuar në "Geopolitical Intelligence Service". Përktheu dhe përshtati nga anglishtja në shqipe: Arsim R. Osmani)**

# Porosia persuasive amerikane: të votohet Kadri Veseli për kryeministër

Këtë porosi duhet ta mbajë në mendje secila votuese dhe secili votues në aktin e votimit: pra të votojmë për bashkëpunimin e ngushtë me aleatin tonë, me forcën më të madhe ekonomike dhe politike të botës - me ShBA-në, ta votojmë PDK-në, nr. 112 dhe Kadri Veselin për kryeministër



Hasan MUJAJ

Zeniti i tërë fushatës zgjedhore u manifestua dhe u kurorëzua me sukses në Gjilan. Kjo ndodhi mbrëmjen e një tetorit 2019.

Në Gjilan folën njëzëri: Anamorava, Kosova dhe Amerika. Aty u trupëzua kulminacioni i gjithë parafushatës e fushatës zgjedhore të Kosovës. Atmosferë hareje e galdimi. Entuziazëm ndjenjash ndaj aleatit më besnik të Kosovës. Në Gjilan u manifestua devotshmëria e Kosovës ndaj burimit të demokracisë, ndaj Amerikës dhe ndaj kultivimit të mëtejshëm të bashkëpunimit Kosovë - ShBA. Në Gjilan nuk qe vetëm Anamorava. Jo. Aty, emocionalisht, qe e tërë Kosova, e tërë diaspora shqiptare. Në Gjilan u rikonfirmua, u nënshkrua dhe u verifikua me vulën e sovranit miqësia e përhershme Kosovë - Amerikë, të cilën dikush e zvetënoi dhe e vuri në dyshim. Mirëpo, sikundër tha zyrtari i lartë amerikan në këtë lloj referendumi, qe Kadri Veseli ai, i cili jo vetëm që e rivendosi përkushtimin e Kosovës për bashkërendim e integrim me ShBA-në, porse e thelloi atë miqësi dhe e shpuri përpara në dritën e iniciativave risimtare të zhvillimit ekonomik e politik të Kosovës.

Zyrtari i lartë amerikan M. Whikater, ndër të tjera, e tha qartë se kë duhet ta votojnë shqiptarët për kryeministër të Kosovës më 6 tetor. Njeriu i presidentit amerikan u bëri thirrje kosovarëve: "Votoni për Kadri Veselin që e forcon miqësinë me Amerikën, të tjerët e rrezikojnë".

M. Whikater shtoi: "Në këto votime zgjedhja është midis: një qeverie që do të forcojë bashkëpunimin me ne Shtetet e Bashkuara për të luftuar korrupsionin dhe për të zhvilluar ekonominë tuaj në mënyrë që të krijohet mirëqenie dhe sukses për të gjithë. Mundësitë tuaja alternative përbëjnë rrezik- bëhet fjalë për një qeveri e udhëhequr nga politikanë që mund ta izolojnë Kosovën dhe t'i dëmtojnë marrëdhëniet tuaja me ne... Kadri Veseli është një reformator. Kadri Veseli është mik i ShBA-së", tha Whikater. Kjo është e vërteta.

Këtë porosi duhet ta mbajë në mendje secila votuese dhe secili votues në aktin e votimit: pra të votojmë për bashkëpunimin e ngushtë me aleatin tonë, me forcën më të madhe ekonomike dhe politike të botës me ShBA-në, të votojmë PDK-në, nr. 112 dhe Kadri Veselin për kryeministër.

Nuk besoj të këtë njeri normal i përkushtuar për zhvillimin ekonomik e politik të Kosovës që i shmanget ofertës së zyrtarit të lartë amerikan. Edhe ata që nuk e duan Kadri Veselin do të duhej ta votonin sepse këtë e kërkon Amerika për interesin e zhvillimit të Kosovës.

Fjalimi i zyrtarit amerikan i hodhi poshtë fjalimet e disa liderëve të tjerë të Kosovës si fjalime me përmbajtje manipuluese, euforike, emfazike, demagogjike etj. që, si të këtilla, mund ta izolojnë Kosovën nga aleatët besnikë, sidomos nga ShBA-ja.

Fjalimet me gërnja e fyerje të disa liderëve partish politike janë të nivelit akulturor; ato mbështeten në maraz, në resë dhe janë shqim naive e fiktive aq sa janë të neveritshme të dëgjohen e lëre më të votohen oratorët e tyre.



# Përurohet aneksi i shkollës 'Dëshmorët e Vërrinit' në Prizren

**Prizren, 3 tetor (ER)** - Në fshatin Billushë të Prizrenit është bërë përurimi i aneksit të ri shkollor dhe të renovimit të objektit ekzistues të shkollës "Dëshmorët e Vërrinit". Në këtë përurim të pranishëm kanë qenë kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, drejtoresha e Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA), Xhemile Thaçi-Vezgishi si dhe stafi dhe nxënësit e kësaj shkolle.

Ky aneks ka një sipërfaqe prej 1 900 metrash katrorë dhe përmban katër klasë mësimi, dy laboratorë, sallën e arsimtarëve, lidhjet sanitare për nxënësit dhe hapësirat e ndryshme shkollore.

Së shpejti, Komuna e Prizrenit, përkatësisht DKA-ja, do ta realizojë edhe inventrazimin e klasave, laboratorëve dhe hapësirave të tjera të kësaj shkolle, me ç'rast për nxënësit e kësaj shkolle do të ofrohet një ambient bashkëkohor dhe cilësor i mësimit.

# Implementohet projekti 'Oppurtunity Scouting' në shkollën 'Hasan Prishtina'

**Mitrovicë, 3 shtator (ER)** - Organizata GIZ ka implementuar projektin "Oppurtunity Scouting" nëpërmjet të cilit ka mbështetur themelimin e kompanive virtuale "We're hiring n'Mitrovicë" dhe "Mitrovica Punëson" në Mitrovicë. Qëllimi i këtij projekti ka pasur për synim ta rrisë punësimin e të rinjve duke përmirësuar cilësinë e arsimit, formimin profesional dhe forcimin e mekanizmave të përputhjes ndërmjet ofertës dhe kërkesës në tregun e punës.

Me këtë rast, në implementimin e këtij projekti kanë marrë pjesë drejtori i Arsimit, Egzon Jashari, drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, drejtori i Shkollës Ekonomike "Hasan Prishtina", Avdullah Bejtullahu, menaxherja e projektit, Kumrije Kelmendi Aliu, si dhe nxënës dhe mësimdhënës nga kjo shkollë.

Në fjalën e tij, drejtori i Arsimit, Egzon Jashari, ka thënë se ky projekt ka ndikuar drejtpërdrejt në ngritjen e cilësive dhe aftësive praktike për nxënësit dhe një shembull i tillë është mirë të vazhdohet edhe nga gjeneratat pasuese.

Përkrahja institucionale që u është dhënë kompanive nga Komuna e Mitrovicës dhe Qendra për Punësim në Mitrovicë është një garant që qëndrueshmëria e kompanisë dhe puna e saj të vazhdojë edhe në vitet në vijim, duke pasur parasysh se vetëm gjatë tri javëve të punës kompania "We're hiring n'Mitrovicë" ka arritur të gjejë mbi 700 biznese aktive që operojnë në regjionin e Mitrovicës, e prej tyre janë kontaktuar mbi 240 sosh, prej të cilave mbi 80 kompani ofrojnë vende të lira pune dhe praktikë profesionale.



# Rezultatet e zgjedhjeve të 6 tetorit:

# LDK-ja e para, LV-ja e para, PDK-ja e para, AAK-PSD e para, Nisma e para, PEK e para, Lista Serbe e para, Sloboda e para, kush do të jetë e dyta?!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Jo parashikim por, thjesht, një fall: Që nga përfundimi i luftës në Kosovë kurrë nuk ka qenë më vështirë të parashikohen rezultatet e renditjes së partive apo koalicioneve, nga vendi i parë e deri te subjekti i fundit në listë e që e kalon pragun. Në të njëjtën kohë, kurrë nuk ka qenë më lehtë të parashikohet fituesi për faktin se të gjitha partitë politike dhe koalicionet, ende pa përfunduar procesi i votimit, e kanë deklaruar veten si fitues sikur që të gjithë kandidatët e nominuar për kryeministër po flasin sikur vërtet të ishin në ato poste dhe vetëm po iu mungon zyra e kryeministrit, në ndërtesën e shëmtuar të Qeverisë së Kosovës. Gjatë fushatës, para zgjedhjeve dhe në ditën kur votohet dalin disa rezultate preliminare që rrallëherë përputhen me rezultatet përfundimtare qoftë edhe nëse kemi parasysh margjinën e lejuar të gabimeve, +-3 për qind. Pse ndodhë kështu? Në fakt, të gjitha subjektet politike i bëjnë sondazhet në bazë të të cilave edhe i marrin veprimet. Nëse këto rezultate janë të favorshme për një subjekt politik atëherë i bëjnë publike kurse, nëse dalin keq, i heshtin dhe bëjnë sondazhe me porosi që të dalin mirë. Ambasadat e huaja dhe agjencitë e huaja i bëjnë sondazhet për nevoja të brendshme dhe për ndërtim të koalicioneve midis partive duke injoruar në mënyrë diplomatike vijat e kuqe apo të tjera. Sondazhe bëjnë edhe mediat elektronike sikur edhe organizata apo individë që paguhen për këtë prandaj, në jo pak raste: "e lidhin kalin ku iu thotë zotëria (porositësi)". Subjektet serioze politike e kanë të qartë këtë, prandaj brenda partisë janë realistë, kurse për opinion bëhen ekzibicionistë! Pas përfundimit të luftës ishte një situatë shumë më e lehtë dhe më e menaxhueshme, si në aspektin e parashikimit ashtu edhe të monitorimit. Lufta politike bëhej midis dy subjekteve politike, LDK-së dhe PDK-së, e që më vonë u ngatërrua skena politike për faktin se kush donte e formonte një parti duke e koreanizuar dhe kinezuar këtë skenë. As në Kinë e as në Kore apo Mongoli nuk keni aq shumë parti për kokë banori si në Kosovë. Në të gjitha zgjedhjet kam parashikuar rezultatet dhe kam qenë tmerrësisht i saktë në renditje të subjekteve politike. As nuk kam bërë sondazhe, as hulumtime por, thjesht, jam mbështetur në analizën time duke marrë parasysh faktorin e brendshëm dhe të jashtëm, proceset politike e sidomos interesin e vendimmarrësve ndërkombëtarë në këto procese. Formimi i koalicioneve pas këtyre analizave ka qenë lehtësisht i parashikueshëm. Bënim baste për ndonjë pije apo darkë e që i fitoja, pa asnjë problem. Herën e fundit, kur flitej për koalicionin parazgjedhor midis LDK-së dhe LV-së, me insistim të disa miqve që të deklarohem nëse do të ketë koalicion apo jo, prerazi kam thënë se nuk do të ketë koalicion të tillë dhe për këtë e kemi fituar nga gjysmë pule unë dhe Artani, por se Milazimi nuk e ka shlyer borxhin, jo pse i dhimben katër euro për një pulë e gjysmë, por se e ka huqur parashikimin. Edhe për lexuesit e "Epokës së re", në një intervistë, disa muaj më parë, pata deklaruar se bisedimet midis LDK-së dhe LV-së shkojnë mirë deri kur arrihet momenti të caktohet infrastruktura qeverisëse. Ashtu ndodhi dhe e njëjta do të ndodhë pas zgjedhjeve! Gjatë parashikimit të zgjedhjeve apo rezultatit nuk më kanë interesuar raportet shoqërore apo simpatia ose antipatia ndaj një subjekti të caktuar politik e që këtë parim e kam edhe sot. Të gjithë lexuesit e kanë të qartë që në çdo analizë për zgjedhjet e 6 tetorit 2019, LDK-në e kam konsideruar si fituese potenciale, PDK-në parti të dytën apo, ndoshta, edhe të parën, LV-në të tretën, AAK-PSD të katërtën, Nismën, pa AKR-në, të pestën etj. Pavarësisht prej rrethanave, asnjëherë nuk e vë në pyetje reputacionin tim për t'i plotësuar dëshirën një partie apo individi. Unë do të dukesha shumë qesharak nëse, për t'i plotësuar dëshirën dikujt, do të deklaroja se LDK-ja nuk e kalon pragun zgjedhor apo se PEK-u do të jetë fitues i zgjedhjeve. Para zgjedhjeve disa subjekte politike apo individë i kapin ethet për faktin se mund ta humbin pushtetin apo se nuk mund të zgjidhen deputetë, por unë nuk jam ai fallxhori që me një hajmali apo hokus-pokus i veshi me pushtet apo i bëj deputetë. Edhe unë kam dëshirë që, ndoshta, një mik imi të bëhet deputet, por se nuk e përkrahi publikisht nëse gjasat e tij apo të saj varen në bisht të sorrës!

Mangësitë apo improvizimet e fushatës: Fushata e të gjitha subjekteve politike vuan nga një kallëp, me ç'rast nuk u kujtohet rëndësi programeve politike, ekonomike, arsimore, kulturore apo zhvillimore, pra ofertës që ka cilësi dhe interes për votuesit, por se krijohet një situatë e fatamorganës apo manipulimit me numrin e pjesëmarrësve në ato tubime, anës sasiore. Nuk diskutohet për ofertën, por diskutohet se a e mbushën sheshin, sallën sportive apo ndonjë hapësirë më të madhe partitë garuese. Nuk i kushtohet vëmendja veshit të votuesit, por syrit! Pjesëmarrja e madhe apo e vogël në tubime të fushatës nuk është pasqyrim real i forcës së subjektit politik e as tregues se sa vota do të fitojë. Nëse analizoni të gjitha subjektet politike, pa përjashtim, se sa arrijnë ta sigurojnë pjesëmarrjen e votuesve, atëherë do të shihni se kemi përsëritje të së njëjtës përbërje, nga vendi në vend, të personave të njëjtë, prandaj më shumë i ngjanë një cirku shëtitës elektoral sesa një fushate të mirëfilltë elektorale. Sot, në kohën kur klientelizmi në Kosovë është shndërruar në shenjë identifikimi dhe mënyrë të të mbijetuarit, aspak nuk është e vështirë ta mbushni një hapësirë me votues shëtitës të shndërruar në shërbyes të partive politike.

Kush do të bëhet deputet dhe mungesa e karizmit: Problemi më i madh i subjekteve politike para zgjedhjeve është përpilimi i listave dhe renditja në lista. Këtu thyhen më së shumti shtizat; autsajderët duan të bëhen pjesë e listës, kurse ata që meritokracinë e kanë me fletë poseduese duan të jenë sa më lart në ato lista. Çdo lider apo subjekt politik, varësisht nga fuqia, e ka një 10-she që, fituan apo nuk fituan votat e mjaftueshme, bëhen deputetë. Është një e vërtetë publike se hajnitë që bëhen gjatë procesit të votimit mund të llogariten si vepra humanitare krahasuar me hajnitë që bëhen brenda partive. Në këtë rast shtyhen ata që mendoni se ju shërbejnë apo eliminohen ata që i konsideroni si problematic guys, çuna problematikë! Hartimi i listave dhe radhitja në lista varet nga kapaciteti i liderit, ndikimi i tij, aftësia për bindje apo karizma. LDK-ja që nga vdekja e Ibrahim Rugovës ka pasur mungesë kronike të liderëve karizmatikë dhe as sot e kësaj dite në LDK nuk ka autoritet të cilit nuk i kundërshtohet apo person karizmatik. Subjektet e tjera politike kanë persona karizmatikë që nuk iu prishet tymi i duhanit pavarësisht e kanë mirë apo jo. AAK-ja e ka Ramush Haradinajn si karizma numër një (1) dhe Daut Haradinajn si karizma numër dy (2). Ata janë Statuti i partisë, Rregullorja e Partisë dhe Kushtetuta e AAK-së. PDK-ja ka disa persona karizmatikë siç janë Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Sami Lushtaku dhe Ramiz Lladrovci. Këta bëjnë ligje në PDK dhe këta e marrin çdo vendim. Në LV karizma supreme është në personalitetin e Albin Kurtit, kurse kseroks karizma (fotokopje) është e Agim Bahtirit. Çka thotë Albini, e vulos Agimi! Në Nisma personi karizmatik është Fatmir Limaj, kurse në hije karizma i takon Jakup Krasniqit. Në Listën Serbe personi karizmatik është Aleksandar Vuçiqi i cili është baba i këtij monstrumi shovinist politik, kurse PSD-ja dhe AKR-ja nuk kanë liderë karizmatikë, ndërkohë që këta që shiten si karizmatikë, karizmën e kanë, ose të shpifur ose të blerë me para. Nenad Rashiqi është lideri i vërtetë karizmatik i serbëve të Kosovës. Tash për deputetë, lista dhe dëshira ime: Në LDK do të dëshiroja të jenë deputetë Kujtimi, Ismeti, Lirija, Marigo, Arbeni, Floriani, Arbani, Vjosa, Doruntina dhe ndonjë përfaqësues i moshës së re që është premtues e jo klient i liderit.

Në PDK, përveç atyre që e kanë mandatin 100 për qind të sigurt, do të doja të jenë edhe Shqiptar Demaçi, Merita Makolli, Abelardi, Valdetja, Liza, Blerimi, Memli dhe Valoni.

Në LV pëlqej të jenë deputetë, Saranda, Fitorja, Besa, Albulena, Glauku, Liburni, Artani, Arbëri, Arbeni etj.

Në AAK përkrah Ahmetin, Donikën, Besnikun, Albenën, Teutën, Davidin etj.

Nisma për Kosovën nuk ka kuptim të përfaqësohet në Kuvend pa Zafirin, Valdeten, Haxhinë e sidomos vlerë e shtuar e Nismës është Bilall Sherifi që ka potencial politik dhe intelektual sa Nisma e AKR-ja bashkë, hiç këtu Jakup Krasniqin i cili, më shumë do të duhej të merrej me histori se me politikë. Pastaj, duke e njohur mirë Jakupin, nuk besoj se Jakupi dhe Begjet Pacolli mund të hanë nga i njëjti kazan.

A do ta kem edhe unë fatin e Hashim Thaçit? Fjalori i dhunshëm që po përdoret në fushatë e ka vënë në siklet Shkëlqesinë e Tij, Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Komandantin e Përgjithshëm të FSK-së, z. Hashim Thaçi. Nga një njeri i kamur dhe i sistemuar, e ka shndërruar në një homeles, njeri pa shtëpi dhe katandi. Pas kërcënimeve që po ua bëjnë kryeministrat e Kosovës, zonja Vjosa Osmani dhe zotëri Albin Kurti se do ta shkarkojnë nga posti dhe se do ta arrestojnë, Hashim Thaçi e ka marrë botën në sy dhe nuk po ka guxim t'i kthehet familjes e as Kosovës për të cilin kanë shumë nevojë, familja në aspektin emocional, por më shumë kanë nevojë qytetarët e Kosovës që aq shumë e duan dhe e respektojnë dhe pa të cilin nuk mund ta paramendojnë jetën. Hashim Thaçi, për shkak të pasigurisë personale dhe fjalorit kërcënues nga dy kryeministrat e Kosovës, zonja Osmani dhe zotëri Kurti, është bërë refugjat duke kaluar tërë kohën larg vendit dhe popullit që i do aq shumë. Të gjithë jemi dëshmitarë për shtegtimin e tij, jashtë vullnetit, në vendet siç janë Japonia, ShBA dhe Franca. Hashim Thaçi shkoi në Francë për të marrë pjesë në varrimin e presidentit Zhak Shirak, kurse nuk mori pjesë në varrimin e Malush Kurleshit, figurë e shquar poliedrike dhe pobratim i Titos. Me trajtimin që po ia bëjmë Hashim Thaçit, duke e detyruar të jetojë në hotele super modeste me shtatë yje (7) dhe duke ngrënë ushqim të thatë sikur puna e biftekut të Nexhatit në Nju Jork, ne po tregojmë se jemi popull që nuk di të respektojë as shtetin e as pushtetin (Hashimin). Mendoj se presidenti Thaçi po pret rezultatin e zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 para se të marrë një vendim; a do t'i kthehet popullit të dashur dhe Kosovës që aq shumë po e ndiejnë mungesën e tij apo do të bëhet Mbreti Hashim Zogu, pasardhës i Ahmet Zogut! Për këtë arsye mendoj se nuk do të ndodhë koalicioni LDK-AAK.

Fituesit dhe jofituesit: Në këto zgjedhje nuk do të ketë fitues, por do të ketë humbës të mëdhenj dhe humbës të vegjël. Jo se votat ua pamundësojnë kurorën me dafina, por se proceset politike ndërkombëtare do t'i përcaktojnë koalicionet si dhe rendin e ditës së aktiviteteve të institucioneve të reja. Për aq sa kam kuptuar, nëse kuptoj fare, rendi i ditës i aktiviteteve të reja pas zgjedhjeve do ta ketë vetëm një pikë: heqja e taksës 100 për qind për mallrat e Dodigut dhe birit të Fahriut, bisedimet fleksibile me Serbinë dhe marrëveshja që shkakton dhimbje. Të gjitha premtimet e tjera mbesin të arkivuara, vetëm si premtime.

Po të mbaheshin zgjedhjet në këtë çast kur po shkruaj, ora 14.30 minuta, 3 tetor, renditja do të ishte: LDK, PDK, LV, AAK dhe Nisma. Deri të dielën mund të ndodhin ndryshime, varësisht nga angazhimi në terren dhe përkrahja ndërkombëtare. Duhet të jeni, së paku i marrë e të besoni se një shtet apo qeveri, pavarësisht prej simpative apo interesit, do t'ju përkrahë publikisht qoftë si parti, qoftë si individ. Për mua është skajshmërisht inkurajues fakti se një ish-prokuror, si puna e Witakerit, në shenjë miqësie dhe respekti e bën një rrugë aq të gjatë e aq të mundimshme dhe si shpërblim i mjafton vetëm një kingburger! Mendoj se ky kingburger do të hyjë në Librin e Ginisit për shkak të çmimit të paguar. Edhe si rezultat përfundimtar nuk shoh ndryshime përveç se për vend të parë do të bëhet luftë e ashpër midis PDK-së dhe LDK-së. Mendoj se çdo subjekt politik që i fiton 25 për qind të votave mund të jetë fitues potencial, me margjinën e lejuar të huqjes, +- 3 për qind.


#PDK112
Merita
Makolli
93
Ndërtojmë të Ardhmen
Për Ty dhe Shtetin


#PDK112
Shqiptar
Demaçi
55
Ndërtojmë të Ardhmen
Për Ty dhe Shtetin

E jashtëzakonshme

# Avioni kalon frikshëm mes ndërtesave të qytetit



Banorët e Brisbejnit mbetën pa fjalë kur një avion transporti nga Forcat Ajrore Australiane kaloi nëpërmjet ndërtesave të larta të qytetit, duke dhuruar spektakël për ata që shihnin nga ballkonet. Fluturimi ishte pjesë e festivalit të përvitshëm të qytetit, që vazhdon pothuajse gjatë gjithë shtatorit. Avionët ushtarakë shënuan kështu mbylljen e festivalit, duke kaluar shumë pranë ndërtesave.



Në fotografi shihen protestuesit antiqeveritar duke vënë zjarr dhe duke bllokuar rrugët në Bagdad /AP/

E rrallë

# Policia e kërkon të dyshuarin për orë të tëra nëpër labirint



Policia u vu në ndjekje të një personi që kishte përndjekur një grua, edhe pse kishte marrë urdhër nga gjykata që të mos i afrohej. Por 29-vjeçari Rajan Keneth Uot, në ShBA, hyri brenda një labirinti të krijuar në një fushë me misër. Policët e rrethuan labirintin dhe që të mos vërdalliseshin kot dhe kërkuan ndihmën e një helikopteri, por as ky nuk bëri punë. Disa nga policët nisën të heqin dorë e të largohen. Mirëpo, për fatin e keq të agresorit, një prej policëve, teksa po largohej i mërzitur, vuri re një kotec pulash pranë labirintit dhe zbuloi se 29-vjeçari kishte qenë gjithë kohën i fshehur aty.

## BARSOLETA E DITËS



**Një zeshkane dhe një bionde vozisin udhës dhe mbesin pa benzinë.**
**- "Pse u ndalëm?", pyet biondina.**
**- "Epo, kemi mbetur pa benzinë", ia kthen zeshkania.**
**- "A po e sheh sa e mençur je ti, unë për vete kisha vozit ende", ia kthen biondina.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Çdo ditë në ora 16:00**

## Toy Story 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

**Rolet:** Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

**Regjia:** Josh Cooley







**Në ora 18:00 dhe 20:00**

## AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

**Rolet:** Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray

**Çdo ditë në ora 22:00**

## DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

**Rolet:** Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

**Regjia:** Michael Engler




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Do të ndiheni të fuqishëm sot, prandaj përdoreni këtë energji që të përfundoni disa projekte të rëndësishme.



**DEMI**
Ju mund të përfundoni shumë gjëra sot. Shfrytëzojeni në maksimum ditën e sotme.



**BINJAKËT**
Merrni kontrollin e vendimeve tuaja. Ju dini si të vepronit në çdo situatë.



GAFORRJA
Ju do të përjetoni disa eksperienca shumë intense sot. Ditë me fat për ju.



**LUANI**
Ju keni shumë energji sot, prandaj përdoreni atë në mënyrë konstruktive.



VIRGJERESHA
Sot do keni mësime të rëndësishme që duhet ti dëgjoni me kujdes.



PESHORJA
Sot duket se ka një atmosferë agresive rreth jush. Mundohuni që ju të jeni i qetë.



**AKREPI**
Fuqia nuk është pjesë e zakonshme e natyrës suaj, por nëse doni të largoni diçka nga jeta, sot është dita për ta bërë.



SHIGJETARI
Sot do keni fuqi të madhe në dorë, por mos e përdorni për keq.



**BRICJAPI**
Zhytuni brenda në vetvete sot dhe jepini botës pak nga shpirti juaj.



**UJORI**
Fjalët tuaja do kenë impakt të tmerrshëm sot, prandaj mendoni para se të flisni.



**PESHQIT**
Nëse duhet të bëni një punë seri-oze investigative, sot është dita e duhur.

# Tyler Cameron ende në lidhje me Gigi Hadidin?




Tyler Cameroni bëri një paraqitje në Watch What Happens Live të martën në Nju Jork. Gjatë bisedës ai u pyet nëse ishte beqar. Përgjigjja e tij ishte: "Unë mund të jem beqar". Ai u pyet më pas nëse do të jetë në lidhje me një femër të famshme dhe ai tha se i do të gjitha vajzat. Nëse nuk e dini, Tyleri ishte në lidhje me Gigi Hadidin për disa javë. Nuk dihet se si qëndron marrëdhënia e çiftit sot.

# Ja pse u ndanë Kylie Jenneri dhe Travis Scotti



Çdo ndarje e ka një histori, edhe pse mund të jetë e përkohshme si ato në Hollywood. Të mërkurën shpërthyen lajmet se Kylie Jenneri dhe Travis Scotti po bëjnë një "pushim" në lidhjen e tyre. Dhe "E!News" ka zbuluar arsyen. "Kylie është e re, por do jetën e një familjeje tradicionale. Ajo ka parë motrat e saj më të mëdha me familje të mëdha e shumë fëmijë dhe do të njëjtën gjë", ka thënë një burim i afërt i miliarderes 22-vjeçare. "Ajo donte të rrinte në shtëpi me Travisin dhe vajzën e tyre Stormi më shumë se çdo gjë në botë. Por tani, prioritetet e tyre janë të ndryshme. Travisi është i zënë me karrierën dhe punën e tij dhe është e vështirë për të të vinte çdo natë në shtëpi për të qëndruar me familjen dhe të vinte Stormin në gjumë. Kjo e bëri Kylien të pasigurt dhe me ankth", ka vazhduar burimi. Sipas tij, ylli i reality shout do të martohet dhe të ketë më shumë fëmijë dhe u bë e qartë që Travisi nuk mund t'ia ofronte asaj një gjë të tillë në këtë çast.



# Dua Lipa nuk i ndahet të dashurit

Dua Lipa dhe i dashuri i saj Anwar Hadid janë parë në lagjen SoHo, të Nju Jorkut, të mërkurën pasdite. Këngëtarja 24-vjeçare kishte të veshur një bluzë të verdhë ndërsa mbante duart me 20-vjeçarin gjatë shëtitjes së tyre. Dua së fundmi ndryshoi ngjyrën e flokëve duke i kthyer ato në të verdhë, duke lënë të kuptohet se një epokë e re në muzikën e saj po vjen "Një epokë e re! Faleminderit për durimin tuaj! Shihemi së shpejti", ka shkruar Dua në rrjetet sociale.

# Dean McDermotti shtrohet në spital




Dean McDermott është shtruar në spital pasi është diagnostikuar me pneunomi. "Kështu ndodhi mbrëmë. U pranova në spital me pneunomi, ndoshta meningjit", ka shkruar në rrjetet sociale aktori 52-vjeçar, ku ka postuar një fotografi të vetes që mbante tuba të frymëmarrjes. "Unë kurrë në jetën time nuk kam qenë kaq i sëmurë", ka pohuar ai.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Drita dhe Gjilani deklasojnë Vushtrrinë dhe Flamurtarin

11 gola janë zhvilluar në dy ndeshjet e zhvilluara të enjten në kuadër të xhiros së tetë në Superligë. Fituese dolën Drita dhe Gjilani në përballje me Vushtrrinë, përkatësisht Flamurtarin. Ndeshja e mbetur e kësaj xhiro në mes të Prishtinës dhe Drenicës zhvillohet më 16 tetor

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 TETOR - Dy ndeshje të javës së tetë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll janë zhvilluar të enjten, kurse kanë shkëlqyer dhe kanë marrë pikët maksimale Drita dhe Gjilani. Ish-kampionia e Kosovës e mposhti në Gjilan skuadrën e Vushtrrisë me rezultat 5-1. Lukas Cardoso dhe Bujar Shabani shënuan në pjesën e parë, duke i krijuar një qetësi për pjesën e dytë kësaj skuadre. Pavarësisht pritjes që të reagojë Vushtrria, në pjesën e dytë ndodhi e kundërta, sepse Drita e pati kontrollin edhe në këtë pjesë dhe arriti të shënojë edhe tre gola të tjerë, dy prej tyre i realizoi Betim Haxhimusa dhe një tjetër Xhevdet Shabani. Golin e nderit për skuadrën mysafire e realizoi Matheus De Paula nga penalltia. Pas këtyre tri pikëve Drita ngrehet në pozitën e parë në tabelë me pikë të barabarta me Llapin dhe Ballkanin. Vushtrria vazhdon të jetë në pozitën e parafundit me pesë pikë të grumbulluara.

Trajneri i Dritës, Adrian Nuhiu, është shprehur i kënaqur me fitoren e arritur në ndeshjen ndaj Vushtrrisë. "Pas golit të parë erdhi qetësia dhe më pas e menaxhuam mirë situatën. Jam i kënaqur me lojtarët e ri që i angazhova në këtë ndeshje ku Krasniqi arriti edhe dy asistime. Shoh një të ardhme të mirë si për lojtarët, po ashtu edhe për klubin tonë. Gjithashtu, shoh një kampionat shumë interesant. Jemi në pozitën e parë, por tabela nga java në javë po ndryshon. Ne përqendrohemi vetëm te ndeshja e radhës dhe nuk shohim më larg", ka thënë Nuhiu.

Ndërsa skuadra e Gjilanit është këndellur pas humbjes në derbin më të madh në futbollin e Kosovës ndaj Dritës dhe është rikthyer te fitorja në ndeshjen e zhvilluar në kryeqytet ndaj Flamurtarit. Ishte pritur një ndeshje më e fortë, por Gjilani shënoi fitore të lehtë ndaj kuqezinjve 1-4. Për mysafirët Gerhard Progni realizoi dy gola, kurse nga një gol e shtuan Bedri Greca dhe Fiton Hajdari. Për Flamurtarin golin e vetëm e realizoi Festim Krasniqi. Në xhiron e radhës Flamurtari i shkon Vushtrrisë, kurse Gjilani e pret Dukagjinin e Klinës. Ndeshja e fundit e kësaj xhiroje në mes të Prishtinës dhe Drenicës nga Skenderaj është shtyrë për datën 16 tetor dhe zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" në kryeqytet.



## Liria mposhti Drenasin, dy ndeshje të tjera përfundojnë baras

Krahas dy ndeshjeve në Superligë, të enjten janë zhvilluar edhe tri ndeshje në Ligën e Parë. Skuadra e Lirisë nga Prizreni ka arritur fitore shumë të rëndësishme ndaj Drenasit me rezultat 0-1. Pas kësaj fitore skuadra e Lirisë ngrehet në vendin e dytë me pikë të barabarta me Malishevën që është në vendin e parë dhe Istogun që renditet në pozitën e tretë. Ndërsa Drenasi zë vendin e tetë me nëntë pikë. Ndeshja në mes të KEK-ut dhe Vëllaznimit përfundoi 1-1, sikurse përfundoi edhe ndeshja tjetër në mes të Vitisë dhe Dardanës.

**IPKO SUPERLIGA**

| | |
|---|---|
| Drita - Vushtrria | 5-1 |
| Flamurtari - Gjilani | 1-4 |
| Feronikeli - Llapi | 1-2 |
| Dukagjini - Trepça '89 | 1-0 |
| Ferizaj - Ballkani | 1-2 |
| Prishtina - Drenica takohen më 16 tetor | |

**Tabela**

| | | |
|---|---|---|
| 1. Drita | 8 | 17 pikë |
| 2. Llapi | 8 | 17 |
| 3. Ballkani | 8 | 17 |
| 4. Feronikeli | 8 | 15 |
| 5. Gjilan | 8 | 15 |
| 6. Prishtina | 7 | 13 |
| 7. Trepça '89 | 8 | 9 |
| 8. Drenica | 7 | 8 |
| 9. Flamurtari | 8 | 7 |
| 10. Ferizaj | 8 | 6 |
| 11. Vushtrria | 8 | 5 |
| 12. Dukagjini | 8 | 4 |

## Bushi: Kosova U21, më lart se Shqipëria

TIRANË, 3 TETOR - Trajneri i Shqipërisë U21, Alban Bushi, e pranoi se Kosova është më lart se kuqezinjtë në këtë grupmoshë dhe se shpresave kuqezi u mungon grinta dhe motivimi. "Kosova? Kundërshtarin e njohim, është i fortë dhe pretendent për t'u kualifikuar. Ka një grup të lidhur, ndryshe nga ne që bëjmë shumë ndryshime, pasi furnizojmë kombëtaren e parë. 3-4 lojtarë të Kosovës, nuk dua të përmend emra, i kemi kontaktuar para dy vjetësh, por nuk kanë pranuar të vijnë me ne edhe pse për ne nuk është problem. Pika e tyre më e fortë është agresiviteti dhe dëshira që kanë për të fituar, diçka që s'e kanë lojtarët tanë. Ne mundohemi t'i motivojmë, por nuk e di pse nuk e kanë në gjak. Mendoj se Kosova është një hap më lart se ne. Po t'i shikosh lojtarët tanë, kanë më shumë cilësi se ata. Por, kjo grinta duket se e mposht cilësinë. Kosova i ka të gjithë lojtarët që luajnë titullarë dhe marrin minuta", ka thënë Bushi.

SHKURT

### Danimarka U19 mposhti Kosovën

Përfaqësuesja U19 në konkurrencën e femrave ka pësuar humbje të thellë në ndeshjen e parë në kuadër të Grupit 12 për kualifikimet e Kampionatit Evropian "Gjeorgjia 2020" kundër Danimarkës me rezultat 0-8. Vashat e drejtuara nga Kushtrim Munishi nuk arritën t'u bëjnë ballë danezeve të cilat në çdo aspekt ishin më cilësore dhe pjesën e parë e mbyllën me katër gola epërsi, derisa po aq gola i shënuan edhe në pjesën e dytë. Katër gola për danezet i shënoi Sofie Lundgaard, derisa me nga një gol kontribuuan Bredgaard, Olivia Moller Holdt, Sarah Sundahl dhe Ea Maiken Rasmussen.

### Shaqiri: Ja pse e refuzova ofertën e Zvicrës

